LIGJ
Nr.9929, datë 9.6.2008

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 8950, DATË 10.10.2002 "PËR GJENDJEN CIVILE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.8950, datë 10.10.2002 "Për gjendjen civile", të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Neni 34 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 34
Deklarimi i lindjes

1. Lindja e fëmijës deklarohet te nëpunësi i gjendjes civile nga prindërit, pjesëtarët madhorë të familjes, përfaqësuesit ligjorë ose kujdestarë dhe, në pamundësi ose në mungesë të tyre, nga personat që kanë të drejtë të vërtetojnë lindjen. Deklarimi mund të bëhet edhe nga përfaqësues të nënës, me prokurë të posaçme.

2. Deklarimi i lindjes së fëmijës së gjetur, të cilit nuk i dihen prindërit, bëhet nga organet e njësisë së qeverisjes vendore, organi i rendit publik, në juridiksionin e të cilit ndodhet vendi i gjetjes, në bazë të procesverbalit të mbajtur në kohën e gjetjes së fëmijës.".

Neni 2

Pas nenit 34 shtohet neni 34/1 me këtë përmbajtje:

"Neni 34/1
Regjistrimi i lindjes

1. Regjistrimi i lindjes së fëmijës bëhet në zyrën e gjendjes civile të vendbanimit të prindërve.

2. Për fëmijën e gjetur, të cilit nuk i dihen prindërit, regjistrimi bëhet në zyrën e gjendjes civile të vendit ku është gjetur.

3. Për fëmijën e lindur jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë nga shtetas shqiptarë, me banim të përhershëm në Shqipëri, regjistrimi i lindjes së fëmijës bëhet në përfaqësitë diplomatike ose konsullore shqiptare në vendin ku ka lindur. Kur kjo është e pamundur, regjistrimi bëhet edhe në shërbimin e gjendjes civile të atij vendi.

4. Kur regjistrimi i lindjeve deklarohet brenda 60 ditëve, për lindjen brenda vendit dhe 90 ditëve, për lindjen jashtë vendit, nëna përfiton shpërblim në masën 5 000 (pesë mijë) lekë.

5. Për të gjitha lindjet e padeklaruara deri tani dhe që kanë kaluar afatin, nëna do të përfitojë shpërblim në masën 5 000 (pesë mijë) lekë, nëse bën deklarimin brenda 60 ditëve nga

hyrja në fuqi e këtij ligji.

6. Fondi për shpërblim për pikat 4 dhe 5 të këtij neni përballohet nga Buxheti i Shtetit dhe tërhiqet pranë njësive të qeverisjes vendore përkatëse.

7. Të gjitha subjektet shëndetësore, shtetërore dhe private, që kanë të drejtë të vërtetojnë lindjen, janë të detyruara që çdo ditë të hënë të dërgojnë në zyrat e gjendjes civile, ku prindërit kanë vendbanimin, njoftimin për lindjet e ndodhura pranë institucioneve të tyre.

8. Njësitë operative të policisë në terren, në bashkëpunim me njësitë e qeverisjes vendore, konstatojnë dhe konfirmojnë, në rrugë zyrtare, rastet e lindjeve dhe regjistrimin e tyre nga personat e parashikuar në nenin 34 pika 2, në zonën që ata mbulojnë.”.

Neni 3

Në nenin 69 pika 1, shkronja “b” ndryshohet si më poshtë:

“b) shkelja ose moszbatimi i dispozitës së parashikuar në pikën 6 të nenit 34/1 dënohet me gjobë në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë.”.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5785, datë 30.6.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi